



Datë: 06.05.2025
Numër Protokolli: 3029/2025

A.nr. 499/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi dhe anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.499/2025 të datës 19.03.2025 të parashtruar nga ankuesja Xh.G, kundër organit të punësimit Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.05.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.499/2025 e datës 19.03.2025 e parashtruar nga ankuesja Xh.G.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 14-117/01-24269/25 i datës 20.02.2025 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile Xh.G (në tekstin e mëtejshëm referuar: ankuesja), më datë 19.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1783/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit me numër 14-117/01-24269/25 të datës 20.02.2025 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës me pretendimin ankimor që ti njihet përvoja e punës gjatë masave të dhunshme serbe për periudhën kohore prej datës 28.02.1992 deri me datë 01.10.1999.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa Këshilli më datë 04.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1783/2024 të datës 19.03.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Letërnjoftim i Xh.G.; Vendimi me numër 14-117/01-24269/25 i datës 20.02.2025 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Letër konfirmimi me nr.594/2015 i datës 19.02.2015; Vërtetim nga MPMS i datës 05.03.2024; Libreza e punës e Xh.G. numri i serisë 116527; Kërkesë me nr.14-117/01-223790/23 e datës 21.11.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 26.03.2025; Përgjigje në ankesë i datës 04.04.2025; Akt Emërim i Xh.G. i datës 16.11.2024; Kërkesë me nr.14-117/01-24269/25 i datës 14.02.2025; Vendim i u.d. Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës me numër Nr.305 i datës 16.05.2024; Përshkrimi i detyrave të punës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuses **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës ankuesja është e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 16.11.2024 në pozitën e punës “Zyrtar për Emergjencë” në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Prishtinës.

Tutje sipas shkresave të lëndës rrjedhë se me vendimin me numër 14-117/01-24269/25 të datës 20.02.2025 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës ka refuzuar kërkesën e ankuses për llogaritjen e pëvojës së punës për vitet 90-ta për periudhën të cilën nuk është dëshmuar me dokumentacionet e nevojshem me arsyetimin si në vijim citoj: *Spektori i Burimeve Njerëzore ka shqyrtuar kërkesën e nëpunës në fjalë të gjitha provat veç e veç dhe ka refuzuar kërkesën duke e arsyetuar me faktin se përvoja e punës të cilën nëpunësja e ka dëshmuar me dokumentacion i është njohur me vendimin nr.305 të dt. 16.05.2024 për të gjithë vitet për të cilat ekziston dëshmi për periudhën e angazhimit. Sa i përket viteve 90-ta përvoja e punës i është njohur deri me datën 28.02.1992 në momentin kur i është mbyllur periudha e angazhimit në punë sipas librezës së punës me nr.serie 116527. Neni 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 i Rregullores (QRK) Nr. 05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik parasheh se përvoja e punës dëshmohet përmes njërës prej dëshmive si vijon për periudhën përpara qershorit 1999 nëpunësi duhet ta dëshmoj përmes librezës së punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar) dëshmive të ofruara nga njësia përkatëse e pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve si dhe ndonjërs nga dëshmitë tjera të listuara në kuadër të kësaj pike. Spektori i Burimeve Njerëzore ka pasur në dispozicion librezën e punës së nëpunës në fjalë ku konform edhe vendimit paraprak të lëshuar me nr.305 të datës 16.05.2024 ka njohur periudhën e përvojës së punës për vitet 90-ta deri me datë 28.02.1992.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i'u referua Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, përkatësisht nenit 1, nenit 6 paragrafi 2 nën paragrafit 2.1 dhe paragrafi 3 ku përcaktohet se: *Neni 1 Qëllimi Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për llogaritjen e pagës dhe të përvojës në punë, për të punësuarit në sektorin publik. 2.Përvoja e punës dëshmohet përmes njërës prej dëshmive si vijon: 2.1.përpara qershorit 1999: 2.1.1.dëshmive të ofruara nga njësia përkatëse e pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve; 2.1.2.librezës së punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar);*

2.1.3.dëshmisë që vërteton se i ka paguar kontributet ai dhe/ose punëdhënësi ku ka punuar, dëshmi të cilat detyrimisht do të verifikohen nga zyrtarët e njësisë përkatëse të pensioneve në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensioneve, sipas dispozitave të aplikueshme nga sigurimi pensional dhe invalidor i Kosovës deri në vitin 1989; 2.1.4.regjistrin të pagave; 2.1.5.kartelës së pagave; 2.1.6.vendimit apo kontrata për themelimin e marrëdhënies së punës; 2.1.7.formularit për paraqitje në sigurim dhe ndërprerje të sigurimit (M1,M-2); 2.1.8.vendimit për pagën, rritje dhe harmonizim; 2.1.9.vendimit për pushimin vjetor; 2.1.10. vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; 2.1.11. vendimit në origjinal të ish Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) së punësimit e në të cilin janë të shënuara të dhënat për stazhin e punës; 2.1.12. vërtetimit nga Agjencia Kosovare për Privatizim, për stazhin e punës në ndërmarrjet shoqërore; 2.1.13. dëshmisë-çertifikatës për pagesën e kontributeve të lëshuara nga organi kompetent komunal në rastin e zejtarëve privat; 2.1.14. vërtetimit të lëshuar në origjinal nga kompania private me vulë dhe nënshkrim, të shoqëruar me një deklaratë nën betim. **3. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore në çdo institucion, në pajtim me këtë rregullore, vendosë për njohjen e përvojës së punës së një nëpunësi i cili merr pagë nga buxheti i Kosovës. Vendimi i përvojës së punës bëhet pjesë e dosjes së personelit për secilin i punësuar dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.** Andaj meqenëse ankuesja nuk ka sjellë ndonjë vendim apo dëshmi që e arsyeton se është larguar nga puna si pasojë e masave të dhunshme si dhe nuk ka dëshmi për përvojën të cilën kërkon ti njihet përvoja e punës pretendimi ankimor për njohjen e përvojës së punës është i pabazuar.

Bazuar në atë që u tha si më lartë dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.499/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses Xh.G;
- Komunës së Prishtinës (Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.